



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

**MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIMIN DHE NDIHMËN E NDËRSJELLË NË
FUSHA ME INTERES TË PËRBASHKËT MIDIS**

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Kryetarja e saj, Znj. Vitore Tusha dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Kryetarja e saj, Znj. Gresa Caka – Nimani, të cilat këtu e më poshtë do të referohen bashkërisht si “Palët” dhe veçmas si “Pala”,

duke pasur parasysh bashkëpunimin e mëparshëm dhe ndihmën e ndërsjellë në fusha me interes të përbashkët midis Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,

duke pasur parasysh dëshirën dhe vullnetin për të vazhduar programet e bashkëpunimit dypalësh në fushat që lidhen me veprimtaritë e tyre, për të ndarë së bashku njohuritë dhe përvojat, përfshirë praktikat më të mira evropiane të së drejtës kushtetuese dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), si dhe për të forcuar kapacitetet e tyre institucionale dhe rritjen e cilësisë së vendimeve,

të ndërgjegjshme për rëndësinë e rritjes së besimit të publikut, me synim përmirësimin e komunikimit me publikun dhe rritjen e transparencës,

duke vlerësuar si të frytshëm bashkëpunimin e mëparshëm, me synim nxitjen e mëtejshme të këtij bashkëpunimi,

duke besuar se kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të ofrojë një kuadër të përshtatshëm për bashkëpunimin institucional në të ardhmen, Palët nënshkruajnë si më poshtë:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka si qëllim zhvillimin e mëtejshëm të një kuadri bashkëpunimi midis Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Neni 2

Veprimtaritë dhe fushat e bashkëpunimit

1. Palët bien dakord të kryejnë veprimtari dhe programe të përbashkëta, me qëllim thellimin dhe shkëmbimin e njohurive për trajtimin e kërkesave kushtetuese, jurisprudencat respektive, teknikat e vendimmarrjes dhe modelet përkatëse të organizimit dhe funksionimit, si vijon:
 - a) Organizimi dhe zhvillimi në mënyrë periodike i vizitave të ndërsjella dhe modaliteteve të tjera të bashkëpunimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
 - b) Organizimi dhe zhvillimi i veprimtarive me karakter formues (periudha *stazhi*) pranë selive respektive në ndihmë të këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe të stafit administrativ të të dyja Palëve.
 - c) Shkëmbimi periodik i njohurive dhe informacionit lidhur me jurisprudencat respektive kushtetuese ose juridiksione të tjera kushtetuese.
 - d) Shkëmbimi i rregullt i njoftimeve për medien, të publikuara për çështjet me rëndësi të veçantë.
2. Palët bien dakord të organizojnë veprimtari bashkëpunimi, me qëllim thellimin dhe shkëmbimin e njohurive, në mënyrë të veçantë dhe fokus të posaçëm, për:

- a) shqyrtimin dhe procedimin e kërkesave kushtetuese;
- b) metodologjinë e arsytimit gjyqësor dhe rolin e këshilltarit *senior* në garantimin e përputhshmërisë me jurisprudencën konstante dhe unifikimin e praktikës gjyqësore;
- c) jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- d) monitorimin e zbatueshmërisë dhe ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;
- e) përvojat në fushën e komunikimit dhe mundësitë për avancimin e metodave të komunikimit me publikun dhe rritjen e transparencës;
- f) përvojat në hartimin dhe zbatimin e planeve strategjike reciproke.

Neni 3

Modalitetet e bashkëpunimit

Palët bien dakord të kryejnë veprimtaritë dhe programet e planifikuara bashkërisht, në mënyrë periodike, sipas modaliteteve të mëposhtme:

3.1. Konferenca shkencore

- a) Palët angazhohen të zhvillojnë konferenca shkencore të përbashkëta që lidhen me fushat e veprimtarisë së tyre, si dhe për tematika të tjera për të cilat mund të bihet dakord.
- b) Palët angazhohen të ftojnë njëra-tjetrën në konferencat shkencore që organizohen në institucionet e tyre.
- c) Palët angazhohen të shkëmbejnë personat referues, materialet informuese dhe shkencore të përgatitura nga departamentet e tyre përgjegjëse për konferencën.

3.2. Veprimtari trajnuese

- a) Palët angazhohen të zhvillojnë programe trajnuese të përbashkëta që lidhen me fushat e veprimtarisë së tyre, si dhe për tematika të tjera për të cilat mund të bihet dakord.
- b) Palët angazhohen të ftojnë njëra-tjetrën në programet trajnuese që organizohen në institucionet e tyre.

c) Palët angazhohen të shkëmbejnë trajnuesit, materialet informuese dhe trajnuese, si: paketat trajnuese, librat, prodhimet audio – vizuale etj., të përgatitura nga departamentet e tyre përgjegjëse për trajnimin.

3.3. Seminare

a) Palët angazhohen të ftojnë njëra-tjetrën në programet e trajnimit që organizohen në institucionin e tyre.

b) Palët angazhohen të organizojnë seminare të përbashkëta mbi temat për të cilat mund të bihet dakord.

3.4. Studime/kërkime

a) Palët angazhohen të kryejnë studime/kërkime të përbashkëta për tema të veçanta që lidhen me funksionet e tyre.

b) Palët angazhohen të shkëmbejnë ekspertët e tyre për temat e studimeve/kërkimeve sikurse mund të bihet dakord.

3.5. Shkëmbime të njohurive dhe përvojave

a) Palët angazhohen të shkëmbejnë njohuri, informacione dhe përvoja për temat dhe sipas mënyrave për të cilat do të bihet dakord. Secila nga palët do t'i dërgojë palës tjetër dokumentacionin e kërkuar në çdo rast, legjislacionin, jurisprudencën, literaturën, studimet, kërkimet dhe materialet e tjera informuese për tema të veçanta.

b) Palët angazhohen të shkëmbejnë delegacione dhe anëtarë të stafëve të tyre, me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe të përvojave.

3.6. Veprimtari të tjera për bashkëpunimin

a) Me marrëveshje me shkrim paraprakisht mes Palëve mund të organizohen edhe veprimtari të tjera bashkëpunimi, të cilat janë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

Neni 4

Mbulimi i shpenzimeve

Shpenzimet e qëndrimit të gjyqtarëve kushtetues, të këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe të stafit administrativ mbulohen nga Pala pritëse, ndërsa shpenzimet e udhëtimit mbulohen nga Pala vizitore dhe/ose donatorët.

Neni 5

Personat e kontaktit dhe komunikimi mes palëve

1. Palët caktojnë një ose më shumë anëtarë të stafit të tyre si persona kontakti përgjegjës për mbajtjen e të gjithë korrespondencës dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe përgatitjen e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Personat e kontaktit çdo 6 muaj përpilojnë një raport për ecurinë e veprimtarisë së bashkëpunimit mes Palëve, duke informuar titullarin e institucionit për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore ose me *e-mail*, duke mos përfshirë format më të shpejta të komunikimit.
4. Me anë të komunikimit me shkrim Palët do të përcaktojnë mënyrën e vënies në jetë të veprimtarive bashkëpunuese të parashikuara në Nenet 2 dhe 3 të kësaj Marrëveshjeje, kohëzgjatjen e programeve të bashkëpunimit, si dhe detaje të tjera që nuk janë përmendur shprehimisht në këtë Marrëveshjeje.
5. Palët do të njoftojnë menjëherë në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e Palëve.
2. Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një afat pesëvjeçar dhe i fillon efektet e saj nga data e hyrjes në fuqi.
3. Ky afat mund të shtyhet për periudha të njëjta, me marrëveshje të heshtur nga palët.
4. Shtesat dhe ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të bëhen me miratim me shkrim nga të dyja Palët.

Neni 7

Përfundimi i Marrëveshjes

1. Marrëveshja përfundon me deklaram të Palëve brenda 3 muajve nga mbarimi i afatit pesëvjeçar.

2. Në rast se njëra prej Palëve tërhiqet nga kjo Marrëveshje para mbarimit të afatit të saj, duhet të njoftojë me shkrim Palën tjetër lidhur me përfundimin e saj.

Neni 8

Dispozita të fundit

Çdo mosmarrëveshje për interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve në mënyrë miqësore ose me mënyra të tjera të ngjashme, në mirëbesim mes Palëve.

Për sa më sipër, përfaqësuesit e të dyja Palëve nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike.

Vitore Tusha



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese
të Republikës së Shqipërisë

Gresa Caka – Nimani



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese
të Republikës së Kosovës

29 shtator 2021
Tiranë, Shqipëri